

Denisa Skënderaj

Mban pozicionin e Avokatit të Shtetit në Nivel Qendror pranë zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar që prej muajit Shkurt 2022.

Znj. Skënderaj është diplomuar si juriste në vitin 2012, ka kryer Master Profesional në “Të drejtën civile” pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2014, dhe Master Shkencor në të “Drejtë Private dhe Biznesi” pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Europian të Tiranës në vitin 2020. Është e pajisur me licensë avokatie nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Në karrierën e saj profesionale, ka qenë pjesë e sektorit juridik në institucione shtetërore si: Porti i Vlorës; Bashkia e Fierit, Ministria e Brendshme. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane, si dhe ka njohuri të gjuhës gjermane dhe greke.